



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 88-të, të mbajtur më 16.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-4398/1 të datës 28.12.2020 me pretendime për parregullsi të kryera nga më shumë persona të cilët janë të angazhuar për nevojat e ///, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse denoncimi nuk përmban pretendime të qarta apo indikacione për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare.

Lënda me numër 12-4398/1 të datës 28.12.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 28.12.2020, një denoncues i panjohur ka bërë denoncim me pretendimet për parregullsi të kryera nga disa persona të cilët dyshohet se janë të punësuar për nevojat e ISHP-së Qendrës së Shëndetit Publik /// dhe është formuar lënda me numër 12-4398/1 nga data 28.12.2020.

Në denoncim, parashtruesi tregon disa persona të cilët dyshohet se janë të punësuar/të punësuar nga ISHP Qendra për Shëndet Publik ///. Duke vepruar kështu, parashtruesi tregon lidhjen e disa punonjësve/personave fizikë të punësuar me persona juridikë në pronësi private dhe njëkohësisht kërkon nga KSHPK-ja që të shqyrtojë punën e personave fizikë të specifikuar, të ardhurat e tyre dhe lidhjen e biznesit me personat juridikë të treguar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konkludoi se denoncimi përmban pretendime të përgjithshme, ndërkohë që nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të saktësuar pretendimet e denoncuara dhe nuk ka mundësi të ofrojë informata shtesë për pretendimet në

kърkesё, pas sё cilёs ka konstatuar se ka nuk janё elementё pёr veprim kompetent pёr rastin nё fjalё.

Duke marrё parasysh sa mё sipёr, KSHPK-ja vendosi si nё dispozitiv tё kёtij vendimi.

Pёrgatiti: A.R.M.

Miratoi: N.B., anёtar i KSHPK-sё

**KOMISIONI SHТETЌОРОР
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Nёnkryetar
Katica Nikolovska**

